



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Adresa: Bashkia Patos , Qyteti Patos

Email : info@bashkiapatos.gov.al

PROCESVERBALI I TAKIMIT DATE 20 TETOR 2022 NE FSHATIN GJINOQAR

Vendi : Fshati Gjinoqar, Njësia Administrative Ruzhdie.

Ora: 13:00

Tema e Konsultimit : “Ngritja e nje pike Grumbullimi per Ullirin “

Baza Ligjore : Në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr. 146/2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në nenin 9 pika 1.3, nenit 27 , të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Pjesëmarrës : Nënkryetarja e Bashkisë znj.Anisa Petani, Sekretari i Këshillit Bashkiak Z.Balil Balilaj, Koordinatorja e Konsultimit Publik znj.Suzana Hysenaj, Drejtori i Ujesjellsit Z.Klaudio Alisinanaj, Drejtori i Bujqesise Z. Orgest Gollosi, Drejtori Ekzekutiv /INFOCIP, Z.Gerti Shella, Rreth 35 banore te zones, perfshire ketu fermere, kultivues te bimes se ullirit, prodhues te vajit te ullirit si edhe perfaqesues te industrise lokale te prodhimit te vajit te ullirit.

Takimin e hapi Sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Balil Balili. Ne zbatim te rregullave dhe te procedurave te percaktuara ne ligj dhe ne rregullore dy jane qellimet me kryesore ne keto takime publike. E para eshte garantimi ne nje mase me te madhe sa me masive e banoreve per t’u bere pjese e politikve te hartimit te projekt-vendimeve perpara se ato të bëhën vendime. E dyta eshte ushtrimi i se drejtes nga ana e banorëve persa i perket te drejtes se informimit te tyre ne raport


me punet qe kryen qeverisja vendore. Takimet tona gjate vitit jane te shpeshta, per faktin se eshte e percaktuar me ligj se cdo vendim qe merret dhe eshte i detyrueshem per t'u bere degjese publike eshte realizuar nga Bashkia ne bashkepunim me Këshillin Bashkiak. Faleminderit të gjithëve per pjesëmarrjen jo vetëm për sot por për te gjitha dëgjesat që janë zhvilluar. Takimi i sotëm është specifik, i vecantë sepse kjo zone është zonë e rritjes dhe kultivimit të bimës së ullirit, prandaj edhe problemi që do të trajtojmë do të jetë specifik ku do të flasin specialistët e kësaj fushe duke filluar nga nënkryetarja e bashkisë , Drejtori i Bujqësisë dhe specialistet e tjerë të kësaj drejtorie.

Nënkryetarja e Bashkisë / Znj.Anisa Petani : Ju falenderoj të gjithëve në emër të kryetarës së Bashkisë që jeni sot prezent në këtë konsultim publik. Një nga prioritetet e punës së kryetares është zhvillimi bujqësor e sidomos në njësinë administrative Ruzhdie. Zona juaj mbahet si një nga zonat me prodhimtarinë më të lartë të ullirit, për këtë arsye vazhdimisht kemi bërë investime në fushën e bujqësisë, duke i parashikuar në buxhetin e bashkisë, sic ka qënë hapja e rrugëve të tokave bujqësore për t'ju ardhur në ndihmë fermerëve. Gjithashtu kemi berë edhe disa projekte për mbështetjen e fermerëve të rinj, grave fermere si dhe projekte të tjera që do të vazhdojnë në vitin 2023 me buxhetin e vitit 2023. Po ashtu ne kemi planifikuar hapjen e një zyre e cila do të shërbejë për të konsultuar të gjithë fermerët për të aplikuar dhe për të fituar grante të ndryshme. Sot jemi mbledhur më tepër përse i përket bimës së ullirit, ku kemi konstatuar edhe problematika si p.sh fermeret nuk arrijnë të shesin vajin e prodhuar. Përse i përket këtyre problemeve por edhe të tjera nëse ju keni, pres kërkesa , sugjerime se cfarë investimesh keni të rëndësishme dhe nevojë në bujqësi në mënyrë që ne t'i parashikojmë aq sa mundemi në buxhetin e vitit 2023 po njëkohësisht të shikojmë mundësi financimi edhe nga donatorë të ndryshëm.

Z. Orgest Gollosi: Faleminderit te gjithëve për pjesëmarrjen . Duke qënë se jemi mbledhur për një problem specifik sic është problem i grumbullimit të vajit të ullirit , e rëndësishme është që sot të dëgjojmë problematikat që ju hasni sepse ju jeni ata të cilët merreni me kultivimin e kulturës së ullirit. Mirëpresim cdo kërkesë, sugjerim dhe ide nga ana juaj.

Z.Myftar Sorra Përshendetje të gjithëve, Faleminderit që na mundësuar këtë dëgjesë publike per ne fermeret e njesise administrative Ruzhdie. Sot për ne qeverisja vendore është një element shumë i rëndësishëm. Dua të shpreh sot disa problematika. E para në lidhje me kultivimin e rrushit, cmimi i shitjes shumë i ulët për vetëm 200 lekë të vjetra kg . E dyta në fshatin tonë janë

hapur shumë rrugë nëpër arra. Sot 105 familje në fshatin tonë janë trajtuar me pronat sipas ligjit 7501 dhe përdorin lehtësisht tokën e tyre, kjo falë punës së kryetarës së bashkisë, Z. Fadil Ismaili i cili na ka mbështetur dhe na ka dhënë ndihmë shumë të madhe. Sot në pamundësi për të qënë kryetarja e Bashkisë, unë kam disa kërkesa: Së pari axhornimi i tokës, ne sot nuk kryem asnjë shërbim në hipotekat e shtetit. Së dyti, sot në zonën ku unë banoj nuk ka ujë të pijshëm, rreth 20 familje nuk kanë ujë të pijshëm, kjo është nevojë familjare themelore. E them këtë sepse na u premtua për ndërtimin e një pusi dhe deri në këto momente nuk është realizuar.



Nënkryetarja Znj. Anisa Petani ; Së pari në lidhje me axhornimin e tokës: për të bërë certifikimin e tokës e para duhet që të gjitha tokat të jenë të axhornuara. Axhornimi kryhet në bashkëpunim me topografet e licensuar, nuk kryhet me topografët e bashkive, cka do të thotë se bëhet me topografë privatë. Për këtë arsye bashkia ka parashikuar për vitin 2023 fonde konkretisht për të bërë axhornimin e tokave. Gjithashtu kjo është përgjegjësi primare e hipotekës, ne i kemi drejtuar me shkresë zyrtare hipotekës dhe do të bashkëpunojmë për të bërë axhornimin e tokave. Theksoj edhe njëherë që kjo varet më tepër nga hipoteka dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ne mund të japim mbështetje financiare. Përsa i përket ujit të pijshëm me ardhjen e lotit të tretë ky problem do të zgjidhet përfundimisht.

Z. Myftar Sorra Në vitin 2018 ne kemi perzgjedhur fshat turistik, kanë ardhur turiste, studente dhe donin të njiheshin me kulturen e fshatit tonë. Deri më sot nuk ka investime në mënyrë që zona të zhvillohet më tej ndër Ministria e Kulturës është shprehur se ka fonde.

Nënkryetarja Znj. Anisa Petani : Për të bërë të mundur këtë që ju thoni, bashkia duhet të cojë projekte tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, ne projektin e kemi cuar por nuk na kanë financuar akoma. Financimi nuk varet varet nga nepor varet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Theksoj dhe njëherë se projektin e kemi realisht dhe mund të vish ta shikosh në bashki.

Z. Nuri Gllava Faleminderit per kete degjese, persa i perket investime nga ana bujqesore ne jemi te kenaqur, por padyshim ka akoma per te bere. **Pengesa jone kryesore eshte se ne jemi pa rruge kryesore rreth 3 km rruge.** Ndërsa per ullirin dhe vajin ketu fabrikat duhet te licensohet dhe persa i perket fermeret duhet ta cojne vajin aty në mënyrë cilësore dhe me standarte.



Z. Tetem Manxhari – Unë jam perpunes i ullirit. Së pari dua të falenderoj Bashkinë Patos për bashkëpunimin dhe punët e mira që ka bërë. Une jam i licensuar, ku shteti shteti shqiptar me ka akorduar 150 milion leke per te bere piken e grumbullimit te vajit. Ajo cka dua unë të them është se ne fermeret akoam nuk dime sesi te veprojmë ne lidhje me prodhimin e vajit. Unë jam biznes i vogel dhe nuk me ka ngelur vaji asnjëherë pa shitur. kjo falë cilësisë që ofrojmë. Fermerët janë vetë “fajtore” sepse duhet te prodhojne vaj me cilesi, bashkia nuk na e shet dot vajin jane bizneset ato që mund te shesin vaj. Ne së pari duhe ti kërkojmë vetes llogari se cfarë produkti i ofrojmë tregut. Në rastin tim, tregatri vjen tek fabrika merr kampionin, ben analizen dhe shikon cilesine. Pra ajo cka dua të theksoj dhe njëher është se të gjithë kultivuesit dhe prodhuesit e vajit të ullirit duhet të rrisin cilësinë e prodhimit dhe më pas do të shohin rezultatet.

Sekretari i Këshillit Bashkiak / Z.Balil Balili : Ne jemi te vetedijshem per problematikat, per vajin e ngelur stok, dhe ajo që kemi menduar **si mundesi zgjidhje eshte ngritja e nje pike grumbullimi per ullirin në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë.**



Drejtori Ekzekutiv / INFOCIP , Z. Gerti Shella: Ju degjova me shume vemendje dhe dua ta ndihmoj kete bisede dhe këtë proces. Bashkia Patos ka nje modele të shkëlqyera të ndërveprimit me fermeret, grupet e interest. Kur kemi diskutuar me kryetaren se kush do të ishte një model në të cilin ne të ftoheshim dhe të jepnim kontributin tonë. Pa hezim e propozuam këtë ndërveprim të sotëm në këtë festë të ullirit. Do ju sjell një shembull për ta kuptuar sesa e rëndësishme është që kjo që po diskutojmë. Në vitet 2005-2006 promovuam një pikë për grumbullimin e ullirit në Tirane, ku pronare ishte znj. Shpresa Shkalla. Ajo pati më pas edhe ndihmën e USAID, pikë së pari fianacimi për të garantuar shtrydhjen e ullirit në temperaturë shumë të ftohtë. Dhe së dyti



celësi i suksesit kanë qënë kontratat e para që u lidhën në Zvicër. Nuk e di se në çfarë faze është bashkia për të lidhur kontratat e para. Tregu është i varfër me vaj ulliri të mirë, supermarketet e Tiranës, nuk kanë vaj ulliri të mirë. Prandaj theksoj se është industri me potencial të jashtëzakonshëm thjesht duhet të gjeni mënyrën për të qënë efiçent. Në momentin që bashkia do të mundet edhe në bashkëpunim me ndërkombëtarët të bëjë kontratën e parë dhe të dytë ku jua jua të garantoni të një cilësi të jashtëzakonshme, mendoj se do të keni sukses. Pra të ndërtohen disa blloqe kontrata të para, sepse është vlerë e jashtëzakonshme këta ullinj qindar vjeçrë në Europë. **Së fundmi, rekomandimi që mund të japim është që të dalim me një kontratë tip, ose të tentohet nga Drejtorinë e Bujqësisë që të mundësohen kontratat e para të eksportit.**

Nënkryetarja Znj. Anisa Petani: Të gjitha këto që ju thatë do të mund të shikohen me kujdes dhe nuk do të ngelen thjesht të shkruara në letër.

Takimi u mbyll në orën 14:00

FOTO – GALERIA E KONSULTIMIT







Balil Balili

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Suzana Hysenaj

**Koordinatorë për njoftimin dhe
Konsultimin Publik**



Gjonogjar me 20.10.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

LISTË PREZENCË MBI:
“NGRITJA E NJE PIKE GRUMBULLIMI PËR ULLIRI”

Nr	Emër	Mbiemër	Qyteti/Njesia/ Fshati	Institucioni/ Subjekti	pozicioni Profesioni	Nr. Kontakti	Firma
1	Eduart	Yabashi	Siqece	Baner	Pa punë	0684294285	
2	Hoxhi	Saufaj	Grize	- 11 -	pa punë	0683515514	
3	Agona	Redafi	Marqelice	-	k. shpirt.	068650410	
4	Amisa	Knipa	Patos	B. Patos	Specialist	069 28 87019	
5	Ting	Isufaj	Bunq	-	Kryetar Klubi	0692489938	
6	Jofika	Golloshi	shkars	B. Patos	Specialist	0693353202	
7	Lejdi	Sekaj	Dikos	shqperi civile		0672431387	
8	Blaina	Jagaj	Zhaner	B. Patos	Ingj. sek. Tj. / Tj. / Tj. / Tj.	0693037333	
9	Orges	Golloshi	Patos	B. Patos	Dr. Bujqësi	0693654661	
10	Suzana	Thyreny	Patos	B. Patos	Koord. Konsultimi	0694881460	
11							
12							

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008” Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Neni 10 “Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore” Te dhënat personale, të mbledhura për qëllime të tjera, mund të përpunohen më tej për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Te dhënat personale të koduara përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin. Përpunimi i të dhënave personale përdoret vetëm për qëllime gazetare, literare ose artistike. Përjashtohet nga zbatimi i nenëve 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhënave personale, sipas këtyre dispozitave, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes



Gjinogjar me 20.10.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

LISTË PREZENCË MBI:
“NGRITJA E NJË PIKE GRUMBULLIMI PËR ULLIRIN”

Nr	Emër	Mbimëri	Qyteti/ Njësia Fshati	Institucioni / Subjekti	Pozicion Profesion	Nr. Kontakti	Firma
1	Xhevdil Beesj.		Shqipëri	buqke	buqta	0676291050	
2	Alfred Gremi		Shqipëri	Buqke	Buqta	069450184	
3	Faton Sankelku		Dukun.	Sp.	SP	0692559324	
4	Markell Topaj		Sipëci	Fermer	Fermer	0684888039	
5	Quindura Gropa		Gropë	shop. Gule	shop. Gule	0698490845	
6	Atan Rozajin		Gropë	At. Transpakti	D.D. Transp.	0693871620	
7	Artur Kursh		Gropë	ANN DP	Koordin.	0692091220	
8	Astuf Murah.		Rezhë	Ekomud		0693319102	
9	Muhammed Kelmaj		Kushkë		Fermer	0693753432	
10	Paolo Cerko		Patos	speciale te	speciale te	0693300227	
11	Guigjola Boleku		Patos	Shop. civile		0683855526	
12	Fatmir Celera		Gjinopol.	Byqet		06826299713	

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale”, Neni 10 “Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistike” I të dhënave personale, të mbledhura gjatë udhës së kërkimit, mund të përpunohen me tej vetëm për qëllime shkencore ose statistike, duke siguruar se nuk janë përpunuar për të marrë masa ose vendime për një individ. Përpunimi i personave lejohen të përdoren vetëm për qëllime gazetare, literare ose artistike. Përfshihen nga zbatim i nenëve 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhënave personale dispononve, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Gjinogar me 20.10.2022

LISTË PREZENCË MBI:
“NGRITJA E NJË PIKE GRUMBULLIMI PËR ULLIRIN”

Nr	Emër	Mbiemër	Qyteti/ Njësia Fshati	Institucioni / Subjekti	Pozicion Profesion	Nr. Kontakti	Firma
1	Mliad	Blushaj	Patos		Praktori	0686716745	
2	Agim	Song	Sqec Zogor.	Parlato	K/sectori RH	0682453149	
3	Shaban	Sogaj	Dreniçe	Ruzhëdino	K/Praktikant	0682681130	
4	Shab	Çelaj	Çimçimçaj	Pomëria		06947200142	
5	Muic	Gllëvara	Çimçimçaj	Ruzhëdino	K/Praktikant	06824404147	
6	Ardi	Rrapaj	Çimçimçaj	B.Patos	Sp.IGT	0692757396	
7	Artid	Hoxha	Patos	B.Patos	Konqeroris	0677684770	
8	Elvinda	Alsinovaj	Çimçimçaj	Fermer	Fermer	—	
9	Jrësi	Xhelaj	Patos	B.Patos	Sp.Integrimit	0684770444	
10	Eftihaj	Shaqirmani	Çimçimçaj	Qytetor	Shërbëtor	0696588430	
11	Marjris	Shabanoj	Patos	Shqetësimi		0692204053	
12							

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale”, Neni 10 “Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistike” 1 të dhënave personale, të mbledhura për qëllime të tjera, mund të përpunohen në të njëjtën mënyrë për qëllime shkencore ose statistike, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Përpunimi i këtyre të dhënave, pengon ushtrimin e së drejtës së lirë së shprehjes